



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1395/1 prot

Datë 03.06.2025

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E
OFERTUESVE TË TJERË

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Auto Manoku Servis Sh.p.k” në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” Marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, ku për secilin lot do të shpallet një operator ekonomik fitues”, me **Loti 2: Nr. REF-44425-04-09-2025**, me objekt “**Loti 2: “Mirëmbajta e mjeteve të transportit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit”**”, me fond limit 4,000,000 (katër milion) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 25.04.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga OE “Vilnik Motors Sh.p.k”, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Ankimues:

OE “AEE SERVICE” SHPK, me NUIS L81530012C, me adresë: Rruga dytësore, mbikalimi i Kasharit, objekt në zonën kadastrale 2105, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a, me adresë: Rruga “Reshit Çollaku”, Godina nr.6/337(në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë.

Subjekte të Interesuar:

OE “Auto Manoku Servis Sh.p.k”, me NUIS L62311016C, me adresë: Tiranë, Kashar, Yrshek, Rruga Nozllaku, Godine 2 kateshe, Kati 1, Zona Kadastrale 3866,Nr. Pasurie 287/28.

OE “Vilnik Motors Sh.p.k”, me NUIS L01314031G, me adresë:

Tiranë, Vaqarr, LALM, Rruga e Kavajës, Ndërtesë 2 katëshe,
Kati 2, Km 6.

Në datën 30.05.2025 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1395/2025 protokoli, me datë 02.06.2025 dhe me numër ankimi elektronik A/2025/5357 e OE “AEE SERVICE” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*” Marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, ku për secilin lot do të shpallet një operator ekonomik fitues”, me **Loti 2: Nr. REF-44425-04-09-2025**, me objekt “*Loti 2: “Mirëmbajta e mjeteve të transportit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit”*”, me fond limit 4,000,000 (katër milion) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 25.04.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Auto Manoku Servis Sh.p.k” dhe OE “Vilnik Motors” Shpk, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Bazuar në nenin 112, pika 4, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime” Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë kriteret që OE “AEE SERVICE” Shpk, pretendon se nuk përmbushen nga operatorët ekonomikë “Auto Manoku Servis Sh.p.k” dhe OE “Vilnik Motors” Shpk, në procedurën e mësipërme të prokurimit, të parashtruara në ankesën me nr. 1395 prot., datë 02.06.2025.

Konkretisht në ankesë pretendohet se nga ana e operatorit ekonomik “Auto Manoku Servis Sh.p.k si më poshtë vijon:

“Ndërkohë oferta e OE Manoku Servis është nën vlerën e ulur mbi 25% të Fondit limit kështu që në bazë të Nenit 27 LPP 162/08/02/2024 kjo ofertë mbetet e pavlefshme dhe si e tillë duhet të skualifikohet”.

Gjithashtu, Konkretisht në ankesë pretendohet për mospërmbushje nga ana e OE “Vilnik Motors” Shpk, të kriterëve si më poshtë vijon:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të disponojë pajisje dhe instrumente minimale të nevojshme për zbatimin e kontratës, si vijon:

- i). pajisje për kontrollin, riparimin & kalibrimin e turbinave të motorrit**
- j). pajisje për kontrollin në presion të difektimit të sistemit të ftohjes;**

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri duhet të paraqesin:

- Dokumenta që vërtetojnë se këto pajisje i ka aktualisht në pronësi ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Deklarata provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 03.06.2025.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Kreshnik Ternova

Anëtar

Anila Malaj

Kryetar

Jonaïd Myzyri